



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Ndryshimet në Rregullën për Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë në Kosovë

Me ndryshimet dhe plotësimet e iniciuara në Rregullin për Shkycjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë ndikohet edhe Rregulla për Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë, andaj bazuar në Nenin 29 të kësaj Rregulle inicojmë këto ndryshime:

1. Shtohet pika ë) në paragrafin 9.3 si në vijim:

ë) udhëzime për konsumatorin mbi të drejtën e tij për të paraqitur apel tek gjykata kompetente për lëndët që kanë të bëjnë me shfrytëzim të paautorizuar, vjedhje dhe abuzim me njehsor, të përcaktuara në Rregullin për Shkycjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë.

2. Plotësohet paragrafi 14.1 si në vijim:

14.1 pas marrjes së ankesës, përveç rastit të paraqitur në Nenin 14.2, dhe në **paragrafin 9.3 ë)**, DMK-ja e rishikon ankesën dhe nxjerrë një vendim ose rekomandim, në përputhje me nenin 14.3 dhe 14.5, mbi referimet e ankesave, në përputhje me planin vijues:

Bashkangjitur: *Rregulla Ekzistuese për Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë në Kosovë*

Ndryshimet në Rregulën për Kushtet e Përgjithëshme të Furnizimit me Energji

Të ndryshohet Neni 28.5, të precizohen më mirë llogaritja e konsumit të paautorizuar, vjedhjes dhe abuzimit me njehsor.

Bashkangjitur: *Rregulla Ekzistuese për Kushtet e Përgjithëshme të Furnizimit me Energji*